



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -059

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES BILATERALE NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË
DUKATËS SË MADHE TË LUKSEMBURGUT PËR PROJEKTIN E
BASHKËPUNITIT PËR ZHVILLIM: “KSV/017: PROGRAMI PËR
MBËSHTETJEN E SHËNDETËSISË NË KOSOVË (FAZA II)”**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES BILATERALE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
QEVERISË SË DUKATËS SË MADHE TË LUKSEMBURGUT PËR
PROJEKTIN E BASHKËPUNITIT PËR ZHVILLIM: “KSV/017:
PROGRAMI PËR MBËSHTETJEN E SHËNDETËSISË NË KOSOVË
(FAZA II)”**

Neni 1
Qëllimi

Me qëllim të përmbushjes së procedurave ligjore të parapara me nenin 4, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, ky Ligj ratifikon Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim-KSV/017: Programi për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë (faza II)”

Neni 2
**Ratifikimi i Marrëveshjes për projektin e bashkëpunimit për zhvillim-KSV/017:
Programi për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë (faza II)**

Ratifikohet Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim-KSV/017: Programi për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë (faza II).

Neni 3
Obligimet Republikës së Kosovës

1. Pas Ratifikimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim me titullin “KSV/017: Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë (faza II)”, obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i kryejë të gjitha obligimet të cilat dalin nga marrëveshja e ratifikuar.

2. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i përmbushë të gjitha kushtet dhe obligimet duke përfshirë edhe ato financiare të cilat dalin nga marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim me titullin “KSV/017: Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë (faza II)”.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -059
30 nëntor 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI